- (c) Ne ofrojmë t'ë realizojmë për Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), punimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në preventiv, me të gjitha projektet teknike, e me kërkesat në detyrën e projektimit apo termat e referencës, nëse është rasti, dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontratës;
 3. Kriteret e Vlerësimit;
 4. Kriteret e Përzgjedhjes;
 5. Specifikimet teknike, Projektet dhe çdo dokumentacion teknik;
 6. Preventivin e çmimeve
 7. Termat e referencës (nëse është rasti)

⁴Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

-
8. Detyrën e projektimit (nëse është rasti)
 9. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 10. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë	

Shtojca2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVESIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa vlerëdo të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Oferta ekonomike e detajuar

Nr	Nr. Analizë	Përshkrimi i Punëve	Njësi	Sasia	Çmimi/ Njësi	Cmimi total
1.						
2.						
3.						
Shuma						
Fondi Rezervë						
Shuma						
TVSH						
SHUMA TOTAL						

Nënshkrimi i ofertuesit _____**Vula****Shënim:** Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (e kërkuar në dokumentat e tenderit)

Shtojca 3.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr.Referencës në faqen e APP-së*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit /entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Të dhënat teknike të punëve objekt prokurimi duhet të përshkruhen sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

SHËNIM: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj: **sipas materialeve bashkëngjitur në formatin PDF**

Specifikimi i Materialeve: **sipas materialeve bashkëngjitur në formatin PDF**

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: **sipas materialeve bashkëngjitur në formatin PDF**

Shënim:

Në zbatim të nenit 36 të ligjit **Nr.162/2020, datë 23.12.2020** “Për Prokurimin publik”, sqarojmë operatorët ekonomik pjesëmarrës, se në rastet kur për *punimet (përfshirë materialet/ produktet)* objekt prokurimi është kërkuar që:

1. Të jenë sipas një standarti ndërkombëtar EN..., në rastet kur ato nuk ekzistojnë, do të pranohen dhe ekuivalentet e tyre të njohura sipas standarteve kombëtare S SH...
2. Në çdo fjali ku kemi referim të markës/ prodhuesit, dhe në ato raste, ku është përcaktuar që produkti/ materiali të jetë “Importi”, “Cilësi e I-rë” etj., pas emërimit të tyre shtohet fjalia “...ose ekuivalente me të”

Shtojca 6.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

GRAFIKUT I ZBATIMIT TË PUNIMEVE

Afatet e realizimit të punimeve: 8 (tetë)muaj (sipas materialit bashkëlidhur në PDF).

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3.Afati i realizimit</i>				
Nr	Përshkrimi i Punëve	Java 1/Muaji 1	Java 2/Muaji 2	Java 3/Muaji 3	Java 4/Muaji 4	Java 5/Muaji 5
1.						
2.						
3.						
4						

Shënim. Autoriteti/enti kontraktor mund të shtojë rreshta në varësi të zërave të punimeve dhe kollona në varësi të afatit të parashikuar për realizimin e tyre.

Shtojca 7.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme përvërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 **Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

Sipas përcaktimeve në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit, sipas Shtojcës 7.

2.2 **Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin **bilancet vjetore**, për vitet financiare (2021,2022,2023) të paraqitura në organet tatimore dhe të konfirmuara nga ana e këtyre organeve të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar"(i ndryshuar). Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM

nr.285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

2.2.2 Për të provuar kapacitetet ekonomike dhe financiare, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021,2022,2023) ku vlera e xhiros minimale vjetore që kërkohet, të jetë **jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës (vlera e fondit limit)**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatorët ekonomikë duhet të kenë **përvojë të suksesshme në kontrata të mëparshme** dhe për këtë duhet të paraqesin:

a) dokumentacion për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë **jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlogaritur të kontratës** që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është **jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës** që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- **Për kontrata të realizuara me ente publike** operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qarte vlera, afati i perfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Certificate marrje në dorezim të perkohshme ose të perhershme.
 - Fatura tatimore përkatëse për çdo situacion
 - Kontrata e Bashkimit të Operatorëve e deklaruar në fazën e tenderimit si dhe marrëveshja e ndarjes së punimeve.
 - Prokura e posaçme e Bashkimit të Operatoreve e deklaruar në fazën e tenderimit.
- **Për kontrata të realizuara me sektorin privat**, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm :
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qarte vlera, afati i perfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);

- Kontratë Sipërmarrje;
- Leje ndertimi, Akt kolaudimi objekti; Çertifikaten e marrjes ne dorezim.
- Situacionin përfundimtar;
- *Fatura tatimore përkatëse.*

Pika 2.3.1 germa “a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 germa “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se Nr.285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave te prokurimit publik” te ndryshuar).

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet te paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin **licencën profesionale të shoqërisë**, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktues dhe Energjise, në bazë të VKM nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të ndryshuar, në përputhje me zërat e punimeve që përfshihen në preventivin e punimeve, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

- | | |
|---|----------------------|
| • Kategoria NP-1 Punime germimi ne toke | Klasifikimi B |
| • Kategoria NP-2 Ndërtime civile dhe industriale. | Klasifikimi D |
| • Kategoria NP-4 Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai..... | Klasifikimi A |
| • Kategoria NP-7 Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi..... | Klasifikimi C |
| • Kategoria NP-12 Punime te inxhinierise se mjedisit | Klasifikimi A |

Për punimet speciale të ndërtimit :

- | | |
|--|----------------------|
| • Kategoria NS-4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to..... | Klasifikimi C |
| • Kategori NS-16 Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm..... | Klasifikimi A |
| • Kategoria NS-18 Punime topogjeodezike | Klasifikimi B |

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe

disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Licensat profesionale duhet t'i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Licensa Profesionale.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me liçencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) **Kodi III.7.B “Shpues profesionist per uje”**. Mbështetur në: Ligj Nr. 9010, date 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”(Ndryshuar me Ligjin Nr 10137, date 11.05.2009 “Per disa ndyshime ne legjislacionin ne fuqi per licensat,autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise”).

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë një punësim mesatar i të paktën **70 (shtatëdhjetë) personave**, të cilët duhet të figurojnë në listepagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore per periudhen e fundit te deklaruar.
- Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi, minimumi per **3 (tre) muajt** e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e Formularit përmbledhës të vetdeklarimit sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gërmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2.3.5 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar **staf inxhinierik drejtues teknik** për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në liçensën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse, CV si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë për periudhën për 3 (tre) muajt e fundit, konkretisht;

- a) 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- b) 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf
- c) 1 (një) Inxhinier Mekanik
- d) 1 (një) Inxhinier Ndertimi
- e) 1 (një) Inxhinier Elektrik
- f) 1 (një) Inxhinier Mjedisi

Për inxhinieret drejtues teknik si mësipërm duhet të paraqitet:

- Kontratë pune e vlefshme
- Diplomë;
- CV

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e Formularit përmbledhës të vetdeklarimit sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si

dhe në gërmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar si **staf teknik për kryerjen e punimeve**, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, pajisur me diploma/certifikata të formimit profesional lëshuar nga Autoritete përgjegjëse të akredituara/licensuara si dhe dëshmi të sigurimit teknik (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriat Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- 3 (tre) punonjës teknik Ndërtimi
- 1 (nje) punonjës Elektricitist
- 1 (një)punonjës Hidraulik
- 1 (një) punonjës murator
- 1 (një) punonjës saldator
- 3 (tre) punonjës karpentiere
- 1 (një) punonjës betonues
- 1 (një) punonjës bojaxhi
- 6 (gjashtë) manovratorë të mjeteve të ndërtimit
- 8 (tetë) shoferë
- 1 (një) specialist ekspert zjarrëfikues

Për keta punonjës ,operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë :

- kontratën individuale të punës;

- Për punonjësit manovrator/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë: Kontratën individuale të punës të vlefshme; leje drejtimi, certifikate e aftësi profesionale për shofer; dëshmi e aftësi profesionale për manovratorë/ automakinistë/ buldozeristë; Në rastin kur mjetet e kerkuara janë të marra me qera, punonjësit (Manovrator/shoferë) nuk kërkohet të figurojnë në liste pagesat e shoqërisë, mund të kontraktohen me kontratë pune.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e Formularit përmbledhës të vetdeklarimit sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gërmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:

Nr	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1				
2				
etj				

- **Operatori Ekonomik ofertues duhet të përcaktojë më anë të një deklaratë nga Administratori i shoqërisë, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Në lidhje me këtë pikë operatorit ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratë pune , Diplomë, CV.**

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij (ose në licensën e shoqërisë) inxhinier të pajisur me certificate të punësuar personel të kualifikuar/ certifikuar shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/ certificate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë 3 (tre) muajt e fundit të paktën

-1(një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, në mbështetje të pikës 4 të nenit 49 të Ligjit Nr.152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", të pajisur me certificate të leshuar nga Drejtoria e MZSH.

- 2 (dy) specialiste të jete të pajisur me certificate për "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

- 1(një) specialist i pajisur me certifikatën në fushën e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

- 1(një) specialist i pajisur me certificate "Përgjegjës për dëmet në mjedis" në përputhje me klauzolat e ligjit 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit".

-1(një) Mjek të përgjithshëm, bazuar në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë" i ndryshuar, ku për përmbushjen e këtij kushti të jete i shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme ose kontratë shërbimi të vlefshme (në rastin kur OE nuk disponon një të tillë), Licensën leshuar nga Urdhëri i Mjekut, Diplomë

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e Formularit përmbledhës të vetdeklarimit sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në germën dh) të pikës 2 të nenit 26 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar).

2.3.8 Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më poshtë:

- Tuba Ujësjiellësi

- Rakorderi Ujësjiellësi

- Matësa Uji

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- **Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit** ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhena të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.
- **Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve e prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve** në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shënim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

Shënim:

Per materialet Tubo HDPE dhe PVC. Kur operatorët ekonomike janë prodhues të paraqitet katalog perkates, leje mjedisore Kodi III.1.A(prodhim i produkteve plastike) dhe certifikaten e cilesise ISO 9001/ ekuivalente e vlefshme.

Kur operatorët nuk janë vetë prodhues të paraqitet kontrata paraprake e furnizimit të vlefshme dhe katalogu perkates, leje mjedisore Kodi III.1.A(prodhim i produkteve plastike) e prodhuesit vendas certifikaten e cilesise ISO 9001, ISO 14001, PASS 99:2012 ekuivalente të vlefshme të prodhuesit na i cili furnizohen.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas artikujve që do të marrë përsipër të furnizojë referuar preventivit të objektit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar

Shënim: Të gjitha normat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të publikuara nga Autoriteti Kontraktor, do t'i referohen edhe ekuivalenteve të tyre, standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto standarte janë unifikuar nga kjo Drejtoria.

d) Për matësat e ujit

- Operatori Ekonomik të paraqesë certificate ose deklarata nga prodhuesi/ distributor i autorizuar që vërteton se standarti i prodhimit të matësive të ujit sipas OIML R49/ekuivalente me të, sipas rekomandimeve të Organizatës Internacionale të Metrologjisë Ligjore.

Operatori Ekonomik të paraqesë certifikaten e aprovimit sipas MID/ekuivalente me të, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9875 datë 14.02.2008 ndryshuar me Ligjin Nr. 10217 datë 21.01.2010, Ligjin Nr. 14/2013 dhe Ligjin Nr. 100/2015. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në datën e hapjes së ofertave.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i certifikuar sipas standarteve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht për:

a) *Certifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (ose "ekuivalente") e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

b) *Certifikatën e menaxhimit të mjedisit ISO 14001-2015 ose "ekuivalente" (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

c) *Certifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018 ose "ekuivalente" (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

d) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë që vërteton integritetin e sistemeve të menaxhimit, sipas standardit ndërkombëtar PAS 99:2012 - "Per integritetin e sistemeve të menaxhimit" ose ekuivalente të saj. Certifikata duhet të jetë në fuqi e vlefshme në datën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ vlerësimi të konformitetit i akredituar nga organizimi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë. Bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar*

e) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë që vërteton sistemin e menaxhimit të cilësisë në saldim sipas, standardit ndërkombëtar EN - ISO 3834-2:2006 - "Certifikatë për sistemin e menaxhimit të cilësisë në saldim" ose ekuivalente të saj. Certifikata duhet të jetë në fuqi e vlefshme në datën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ vlerësimi të konformitetit i akredituar nga organizimi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë. Bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar*

f) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë që vërteton sistemin e menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor sipas, standardit ndërkombëtar ISO 39001 - 2012 "Certifikatë për menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor" ose ekuivalente të saj. Certifikata duhet të jetë në fuqi e vlefshme në datën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ vlerësimi të konformitetit i akredituar nga organizimi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.*

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të disponojë certifikatat ISO të vlefshme, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Çertifikatat e mësipërme kërkohen të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit, dhe të jenë në përputhje me nenin 30 të V.K.M. Nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar.

2.3.10 Operatori ekonomik të paraqesë Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

<i>Nr</i>	<i>Lloji i Makinerive</i>	<i>Statusi</i>	<i>Sasia</i>
A.	MAKINERI TEKNOLOGJIKE DHE MJETE		
1	Eskavator me zinxhir	<i>në pronësi ose me qira</i>	2
2	Minieskvator me targa (mt)	<i>në pronësi ose me qira</i>	2
3	Eskavator me goma	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
4	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 25 ton	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
5	Autobot uji	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
6	Rrul vibrues (ngjeshes)	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
7	Fadrome me goma	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
8	Grejder	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
9	Minifadroma me goma me targa (mt)	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
10	Kamione me vinc	<i>në pronësi ose me qira</i>	2
11	Kamioncina me kapacitet mbajtes deri ne 5 ton	<i>në pronësi ose me qira</i>	3
B	Emri i pajisjeve		
1	Betoniere	<i>në pronësi ose me qira</i>	3
2	Tokmak	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
3	Aparatura per bashkimin tubacionesh me metodën "Elektro Fusion Joint"	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
4	Moto gjenerator	<i>në pronësi ose me qira</i>	2
5	Cekic pneumatik	<i>Pronësiose me qera</i>	1
6	Saldatrice/motosaldatrice	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
7	Fabrike Betoni pajisur me leje mjedisore	<i>Pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi</i>	1

- Eskavator me zinxhir ky mjet është kërkuar për hapjen e kanaleve në rrugë dhe terrene të vështira
- Eskvator me goma ky mjet është kërkuar për hapjen e kanaleve në rrugë të asfaltuara
- Kamion me vinc ky mjet është kërkuar për ngritjen e materialeve të ndërtimit
- Minieskvator me targa (mt) janë kërkuar për hapjen e kanaleve në rrugë dhe terrene të ngushta ose për lidhjet me abonentet.

-
- Autobot uji për pastrimin e sipërfaqes pas punimeve
 - Rrul vibrues për ngjeshjen e rrugës për kthimin në gjendjen e mëparshme
 - Fadromë me goma për hapjen e kanaleve dhe inerteve
 - Grejder për grryerje të rrugës
 - Minifadroma me goma me targa (mt) për hapje inerte në terrene të ngushta
 - Kamione me kapacitet mbajtës jo më pak 25 ton për transportin e inerteve
 - Kamioncina me kapacitet mbajtës deri në 5 ton për transport baze materiale dhe vegla pune
- Kokore minimumi 70 copë - Jeleke fosforeshent 70 cope
 - Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë
 - Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 copë

Shënim: Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të makinerive dhe pajisjeve të kërkuara më lart, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqiten:

a) Për makineri dhe mjete që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronësinë e mjetit: çertifikatë pronësie, leje qarkullimi, çertifikatë e kontrollit teknik, siguracionin, leja e transportit që leshohet nga njësia vendore.

b) Ndërsa për makineri dhe mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës;

c) Për makineri dhe mjete që nuk shënohen në regjistra publikë (makineritë), kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse.

Për fabrikën e betonit, në rast se është në pronësi duhet të paraqiten dokumente që vertetojnë pronësinë e saj, Leja mjedisore leshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit. planimetri dhe dokumentacion që verteton pronësinë e fabrikës.

Në rast se fabrikën e betonit, është me qera duhet të paraqitet kontrata e qerave e shoqëruar me dokumente që vertetojnë pronësinë e saj, Lejen mjedisore leshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit. Planimetri dhe dokumentacion që verteton pronësinë e fabrikës.

Në rast se fabrikën e betonit, nuk është në pronësi ose me qera të paraqitet një aktmarreveshje /kontrate porosie me furnizuesin ku të pasqyrohet sasia, cilesia, periudha e furnizimit si dhe penaltetet në rast të mosrespektimit të kushteve të aktmarreveshjes. Kjo aktmarreveshje duhet shoqëruar dhe me dokumentat e pronësive të furnizuesit, leje mjedisore tipi B. Planimetri dhe dokumentacion që verteton pronësinë e fabrikës.

d) Ndërsa për pajisjet e marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë (bashkëngjitur fature zhdoganimi/fature tatimore blerje) e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës.

h) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilën makineri dhe mjete dhe pajisje të deklaruar.

i) Për makineritë dhe mjetet, fotoja duhet të ketë të dallueshme edhe targën e mjetit.

j) Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara në procedura të shpallura fitues.

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë me shkrim nga administratori i shoqërisë mbi vendodhjen e mjeteve.

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”, sjellim në vëmendje se:

Disponimi i punonjësve dhe i mjeteve/pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit (Shtojca 8) gjatë fazës së ofertimit.

- **Operatori ekonomik duhet të paraqesë Analizat e çmimeve të preventivit, Plan – organizimin dhe metodologjinë e punimeve në objekt sipas kërkesave të përcaktuara nga KTP dhe KTZ në fuqi, si dhe Grafikon e punimeve të firmosur e vulosur nga përfaqësuesi i ofertuesit.**
- **Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratën ku të shprehet se është dakord me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor (në rast të shpalljes fitues).**
- **Paraqitja e kësaj deklarate është kërkuar, pasi burimi i financimit për këtë procedurë është Buxheti i Shtetit, e përcaktuar edhe në Dst . Financimi është parashikuar në buxhetin 2024-2026, edhe pse afati i realizimit është sipas grafikut të punimeve.**

- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit do t'i kërkojë ofertuesit të kualifikuar i pari nëpërmjet SPE që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit për disponimin e punonjësve, mjeteve/pajisjeve do të jetë kusht skualifikimi.

- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht skualifikimi.

Shënim: Mosdorëzimi i informacionit të saktë apo dorëzimi me të dhëna të rreme, do të konsiderohet kusht për s'kualifikim dhe/ose fillim të hetimit administrativ për përjashtimin e Operatorit Ekonomik nga procedurat e prokurimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rremeose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik

(nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

• Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

• Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: SHKAQET E PËRJASHTIMIT

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, Deklaroj Se:

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër⁵.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

çmimet;
metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

⁵Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

